European Union
Kosovo

Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta

IPRproject
Intellectual Property Rights Project




ATA NUK MË RESPEKTOJNË!
EDHE XHAXHAI ME HALLËN U TALLËN ME MUA KUR U THASHË SE DOJA TË BËHESHA ARTIST...
A ËSHTË KJO E DREJTË? PO PRINDERIT E TU?
ATA MË QËNDRUAN PRANË...
LUM TI!
BABAI U BËRI NJË PYETJE...
A E PËRFYTYRONI DOT NJË BOTË PA ARTISTË?
FILM
TEATËR
LIBRA
MUZIK
ART
KËRCIM
TELEVIZION
SKUL
ETJ...
NË FAKT...
DO TË ISHTE E MËRZITSHME!
S'DO ISHTE JETË!
E ZYMTË


PA ARTE, QËNIET NJERËZORE DO TË ISHIN ... MË PAK NJERËZORË, DO TË NGJANIN MË SHUMË ME KAFSHËT NË EGËRSI.
MEGJITHAT...
KA NJERËZ QË ARTIN NUK E KONSIDEROJNË PUNË, KËSHTU ATA AS QË KANË IDE PËR RESPEKTIN QË E MERITOJNË ARTISTËT.
PIKËRISHT! KËSHTU JANË PRINDËRIT E MI!
BOOKSTORE
DO TË VUASH URIE MUZIKANT, KE PËR TA PARË...
HO, HO, HO!
GABIM, SEPSE TANI E DI SI TA FITOJ RESPEKTIN!
BUDALLALLËK! JANË VETËM FJALË!


PËRSHËNDETJE! SI ËSHTË PUNA?
PËRSHËNDETJE, ÇULI!
ÇFARË SURPRIZE QË ERDHE!
PO FLASIM SE SI MUND TË MBIJETOJ DUKE U MARRUR ME ART ?
RESTAURANT
AH, KJO ËSHTË E LEHTË! THJESHT KËRKO TË DREJTËN E AUTORIT.
A MUND TË MË NDIHMOJË E DREJTA E AUTORIT TË SIGUROJ JETESËN ME ARTIN TIM?
MENDO, MARCO: JE DUKE ECUR NË RRUGË...
DHE SHIKON NJË SHTËPI APO NJË MAKINË QË TË PËLQEN... A E MERR DOT?
NATYRISHT QË JO, KUPTOHET! VETËM PO TË JETË E IMJA...
OSE PO MË DHA LEJE PRONARI.


KJO ËSHTË: ÇDO NJERI E DI KËTË, APO JO? ATËHERË...
NËSE TI KRIJON NJË KËNGË APO SHKRUAN NJË LIBËR, CILA ËSHTË LIDHJA JOTE ME TË?
JAM AUTORI!
PRA, AUTORI ËSHTË PRONARI I KRIJIMIT TË TIJ: ËSHTË E TIJ SEPSE AI E KRIJOI ATË.
PËR TA BËRË ATË AI KA PUNUAR SHUMË, DUKE INVESTUAR KOHË, PËRPJEKJE, TALENT, SHPESH EDHE PARANË E TIJ.
OK.
DHE ASKUSH NUK MUND TA MERR PRONËN PA LEJEN E PRONARIT.
I VETMI QË KA TË DREJTË MBI NJË VEPËR, TA SHESË APO TA JAPË ATË ME QIRA, DUKE LEJUAR QË AJO TË RIPRODHOHET, APO TA LIÇENSOJË ATË E KËSHTU ME RADHË, ËSHTË AUTORI.
AWKOR!
5


ATËHERË... NËSE UNË KRIJOJ NJË VEPËR, A MUND TË FITOJ PARA NGA AJO?
SIGURISHT, DHE ATËHERË PRINDËRIT DO TË TË LËNË REHAT.
NDRYSHIMI ËSHTË SE SHTËPITË DHE MAKINAT JANË SENDE QË MUND T'I PREKËSH.
KRIJIMET INTELEKTUALE (KËNGËT, POEZITË, SKENARET, KËRCIMET, ETJ.) JANË GJËRA QË NUK PREKEN.
POR TË GJITHA GJËRAT, SI FIZIKE ASHTU DHE MENDORE, KANË PRONARË TË DREJTAT E TË CILËVE DUHEN RESPEKTUAR.
ROLINS
ROLINS
BACK KRASH
BACK KRASH
MEDIUMI ËSHTË FIZIK (LETRA, DISKU, KASETA) KRIJIMI ËSHTË MENDOR
KËSHTU QË, NËSE TI DËSHIRON TË BËHESH ARTIST DHE TË SIGUROSH JETESËN ME VEPRËN QË KE KRIJUAR, DUHET TË DISH MË SHUMË PËR TË DREJTËN E AUTORIT.
E DREJTA E AUTORIT
6


SI KA MUNDËSI QË DI KAQ SHUMË PËR TË?
SHKOVA NË ZYRËN E TË DREJTËS SË AUTORIT DHE...
MË DHANË KËTË BROSHURËN.
E DREJTA E AUTORIT
ATËHER, NA TREGU MË SHUMË!
E KEMI PARË PJESËN KRYESORE...
1 VLERA E KRIJIMTARISË
KRIJIMTARIA BËNË QË BOTA TË RROTULLOHET...
2 E RËNDËSISHME ËSHTË TË MOS HARROJME SE AUTORI ËSHTË PRONARI I VEPRËS SË TIJ...
E CILA 3 I JEP ATIJ TË DREJTA QË DUHEN NJOHUR DHE MBROJTUR.
7


KUSH MUND TË QUHET AUTOR?
VETEM QENIET NJERËZORE JANË NË GJENDJE TË PRODHOJNE VEPRA, KESHTU QE NJE NJE KAFSHE, MAKINE APO INSTITUCION NUK MUND TË QUHET AUTOR.
MË FAL, AURORA...
AWKOR!
TI VETËM IMITON, TI NUK KRIJON.
E SHKRETËZA! POR A NUK KA LLOJE TË TJERA AUTORËSIE?
PO, KA EDHE...
AUTORËSI TË PËRBASHKËT
AUTORËSIA E VEPRAVE PSEUDONIME (TË SHKRUARA ME EMËR PSEUDONIM).
AUTORËSIA E VEPRAVE ANONIME (PA FIRMË)...
DHE AJO E VEPRAVE TË KRIJUARA PËR NJË PUNËDHËNËS.
PUBLISHING Co.
DHE PO SIKUR TË DYJA PALËT NUK BIEN DAKORD PËR ASGJË?
NË PËRGJITHËSI PREZUMOHET QË TË DREJTAT PËR VEPRAT E KRIJUARA ME POROSI OSE SI PUNËMARRËS I TAKOJNË PUNËDHËNËSIT.
SHIKO,


PRA...
CFARE MBRON NE TE VERTETE E DREJTA E AUTORIT?
E DREJTA E AUTORIT MBRON KRIJIMET NE FORMEN E VEPRAVE LETRARE DHE ARTISTIKE, PAVARESISHT LLOJIT, MERITES APO QELLIMIT.
ENGIN-EERING
PHILO-SOPHY
ART HISTORY
SOCIOLOGY
POETRY
PSYCHO-LOGY
A DUHET TA RREGJISTROSH VEPRËN QË TË KUALIFIKOHET?
ËSHTË GJITHMONË IDE E MIRË TË RREGJISTROSH NJË VEPËR, POR TË DREJTAT NË TË VËRTETË RRJEDHIN NGA AKTI I KRIJIMIT TË VEPRËS..
KËSHTU QË NUK ËSHTË KRYESORE RREGJISTRIMI; KJO E DALLON TË DREJTËN E AUTORIT NGA E DREJTA E MARKËS TREGTARE...!
SAKTË.
MAAARKSS!
E DREJTA E AUTORIT ËSHTË NË KRIJIMTARI, SI P.SH. NË MUZIKË... DHE TË DREJTAT E BLERËSIT QËNDROJNË MBI SENDET FIZIKE, SIÇ JANË DISQET.
...?
Ë, Ë... MË FAL? NUK E KUPTOVA.
LE TË THEMI QE BLEVE NJË DISK: TY TË LEJOHET TA DËGJOSH POR JO TA TREGTOSH KËNGËN...
IMAGINE
E DREJTË: UNË JAM PRONAR I DISKUT NDËRSA PRONARI I KRIJIMIT ËSHTË AUTORI.
9


POR NESE USHTROJ NJE BIZNES, A MUND TA PERDOR (DISKUN) KENGEN PER TE TERHEQUR KLIENTET?
VETËM NËSE PAGUAN PËR PËRDORIMIN: KI PARASYSH QË: TA BLESH DISKUN DO TË THOTË QË TA DËGJOSH, ËSHTË E DREJTA JOTE E VETME.
ONNYRIKE!
PO PËR ATË QË KRIJON NJË PROGRAM KOMPJUTERI?
COPYRIGHT
KONSIDEROHET SI VEPËR LETRARE; AI ËSHTË REZULTAT I ZOTËSISË SË NJERIUT...
DHE PËR SA KOHË MBROHET NJË VEPËR?
PËR SA KOHË AUTORI ËSHTË GJALLË DHE PËR 50 VJET PAS VDEKJES SË TIJ.
NË SHUMË SHTETE KJO MUND TË ZGJASË DHE 70 VJET
DAKORD, ATËHERË NJË ARSTIST MUND TË SIGUROJË JETESËN ME VEPRËN E TIJ...!
HE MADJE PËR SHUMË KOHË! PO PAS KËSAJ?
AJO HYN NË SHËRBIMIN PUBLIK, DHE RIPRODHIMI ËSHTË PA PAGESË.
PO NËSE DIKUSH TJETËR THOTË MË PAS SE VEPRA ËSHTË E TIJ?
NUK MUNDET. TË DREJTAT MORALE TË AUTORIT (AUTORËSIA DHE KONTROLLI MBI VEPRËN) ZGJASIN PËRJETËSISHT.


PIRATERIA
dhe
PLAGJIATURA
PIRATERIA ËSHTË RIPRODHIMI I PAAUTORIZUAR, SHITJA, MARRJA ME QIRA APO ÇDO FORMË TJETËR PËRDORIMI I VEPRËS.
GATI?
PLAÇKITNI, ZEMËR!
DHE S'KEMI PSE TË PAGUAJMË!
PLAGJIATURA ËSHTË SHPËRNDARJA E VEPRËS SË DIKUJT TJETËR PAS KOPJIMIT TË SAJ FJALË PËR FJALË OSE PERIFRAZIMI I SAJ, DHE DHËNIA E AUTORËSISË NJË PERSONI TJETËR.
VEPRA JUAJ? POR UNË E KAM LEXUAR KËTË NGA NJË AUTOR TJETËR?
HË, ...SHIKO, PO KJO?
TË DYJA JANË SHKELJE TË TË DREJTËS SË AUTORIT, DHE KJO ËSHTË VEPËR PENALE!
KRIIIM!
POR NGANJËHERË MUND TA PËRDORNI NJË VEPËR PA KËRKUAR LEJEN E AUTORIT.
E SAKTË. PËR SHEMBULL KUR DËGJOJMË MUZIKË NË SHTËPI PËR QEJF...




WIPO Publication No. 484(E) ISBN 978-92-805-1036-2SI

Ky libërth është botuar me përkrahje nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e IBF International Consulting dhe EPLO dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

**Përshtatja:** Projekti "Mbështetja për të Drejtat e Pronësisë Industriale në Kosovë"
**Përkthimi në shqip** © Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta
**Përgjegjësia:** INDECOPI dhe Sekretariati i WIPO nuk marrin asnjë përgjegjësi në lidhje me përshtatjen ose përkthimin e përmbajtjes origjinale.
**Origjinali në anglisht** © Organizata Botërore për Pronësi Intelektuale (WIPO), botuar me marrëveshje me Institutin Kombëtar për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Mbrojtjen e Pronës Intelektuale (INDECOPI) | **Skenari dhe krijimtari e artit:** Juan Acevedo | **Dizajni:** Germán Luna, Jorge Llahuala | **Ngjyrat:** María Elena Sialer